

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6563
E shtunë, 19 mars 2022
çmimi 0.40 €

Arbitrazhi dhe
ndërmjetësimi, mundësi
për bizneset për zgjidhjen
e kontesteve | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KANCELARI I AUSTRISE VIZITON KOSOVËN, PRITET ME NDERIME
SHTETËRORE NGA KRYEMINISTRI KURTI | FAQE 4-5

AUSTRIA KËRKON TË PËRSHPEJTOHET PROCESI I ANËTARËSIMIT TË KOSOVËS NË BE

- Kancelari austriak: Do të jetë e rëndësishme për ne që edhe Gjermaninë ta përfshijmë në përsheptimin e anëtarësimit të Kosovës në BE



Kancelari i Austrisë, Karl Nehammer, i ka dhënë mbështetje Kosovës për anëtarësimin në Bashkim Evropian (BE). Në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Albin Kurti, ai ka thënë se do të angazhohet personalisht për integrimin e Kosovës në BE dhe për liberalizimin e vizave. Kancelari austriak ka thënë se procesin eurointegruës do ta përsheptojnë edhe me Gjermanisë, e cila është aleate e madhe e Kosovës. Ndërsa kryeministri Kurti ka kërkuar ndihmën e Austrisë për rritjen e fondeve të BE-së për Kosovën. Gjithashtu, Kurti ka kërkuar ndihmën e Austrisë edhe për liberalizimin e vizave dhe anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

I bëhet thirrje qeverisë që ta nisë aplikimin për anëtarësim në Këshillin e Evropës

Edhe pse janë bërë 14 vjet që nga shpallja e pavarësisë, Kosova vazhdon të mbetet jashtë prej disa organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare, duke përfshirë këtu Këshillin e Evropës. Me përjashtimin e Rusisë nga ky institucion janë shtuar zërat për

zhvillimin e procedurave për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Ditë më parë edhe raportuesja e Parlamentit Evropian, Viola von Cramon, ka thënë se e mbështetë plotësisht aplikimin që Kosova të bëhet pjesë e Këshillit të Evropës | FAQE 4-5



AKTUALE



THEODORA BAKOYANNIS
ZGJEDHET RAPORTUESE PËR
KOSOVËN NË ASAMBLENË
PARLAMENTARE TË KE-së | F. 5

UKRAINA NJOFTON: 14 200
USHTARË RUSË TË VRARË QË PREJ
NISJES SË LUFTËS | F. 2

JASHARI: PAGA MINIMALE TË
NGRIHET EDHE PËR KATEGORITË E
DALA NGA LUFTA | F. 7

NIS PUNËN SHËRBIMI
STOMATOLOGJIK PEDIATRIK NË
SKENDERAJ | F. 6

EKONOMI



KELMENDI: NËSE PAGA MINIMALE
DO TË ISHTE 700 EURO ASKUSH
S'DO TË IKTE NGA KOSOVA | F. 8

QEVERIA I KONSIDERON SEKRETE,
NUK FLET PËR REZERVAT
SHTETËRORE | F. 8

SPORT

"FINAL 4" I LIGËS UNIKE,
SHPALSEN HOLLËSITË
E ORGANIZIMIT | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina njofton: 14 200 ushtarë rusë të vrarë që prej nisjes së luftës

KIEV, 18 MARS - Në ditën e 23-të të luftës, Ministria e Mbrojtjes e Ukrainës ka bërë përditësimin e fundit. Ajo ka njoftuar se 14 200 ushtarë rusë janë vrarë prej shpërthimit të konfliktit. Por, Ukraina dhe Rusia paraqesin të dhëna të ndryshme për fitoret dhe humbjet e palës tjetër.

Rusia ka raportuar më 3 mars se 498 ushtarë të saj janë vrarë në luftime, mirëpo prej atëherë nuk ka përditësuar të dhënat.

Zyrtarët amerikanë kanë thënë të enjten se numri i viktimave ruse mund të jetë mbi 7 000 dhe i të plagosurve mbi 14 000.

Ukraina, po ashtu, ka pretenduar se ka shkatërruar 450 tanke ruse, 93 aeroplanë, 112 helikopterë dhe ka dëmtuar 43 sisteme kundërajrore.

Kryebashkaiaku i Kievit, Vitali

Klitschko, është shprehur se ukrainasit janë gati të luftojnë për ta mbrojtur vendin dhe familjet e tyre. I veshur me antiplumb, para medieve, Klitschko ka thënë se Putini po bën gabim të madh, prej të cilit po vdesin shumë persona. Teksa i kërkoi Evropës të qëndrojë krah Ukrainës, kryebashkiaku tha se Putini është rrezik i madh për të gjithë botën.

Lagja Podil në Kiev në mëngjesin e së premtes ka qenë shënjestër e sulmeve ruse, ku janë goditur shumë banesa. Nga sulmet ka mbetur i vdekur një person dhe janë plagosur pesë të tjerë. Po ashtu, 95 persona të tjerë janë evakuuar. Dëmi material ka qenë i madh, pasi janë goditur banesat dhe, siç duket nga pamjet, çdo gjë ka mbetur e shkatërruar.



Scholz bisedon me Putinin dhe i kërkon armëpushim në Ukrainë

Kancelari gjerman Olaf Scholz i ka bërë thirrje presidentit rus Vladimir Putin që të urdhërojë ndaljen e sulmit të Moskës në Ukrainë dhe të mundësojë zgjidhje diplomatike, duke shmangur edhe katastrofën humanitare.

Zyra e Scholzit ka thënë përmes një deklarate se të dy liderët kanë folur në telefon për gati një orë lidhur me "luftën në Ukrainë dhe përpjekjet për t'i dhënë fund asaj". Nuk janë dhënë detaje të tjera, mirëpo Kremlini

ka thënë, në një deklaratë tjetër, se "pala ruse është e gatshme të kërkojë zgjidhje në përputhje me qasjet e saj parimore". Prej sulmit të përvokuar të Moskës në Ukrainë, më shumë se 187 000 persona kanë shkuar në Gjermani, ka thënë Ministria e Brendshme në Berlin. Më shumë se dy milionë refugjatë kanë hyrë në Poloni dhe një pjesë e tyre më pas ka kaluar në shtetet e tjera.

Australia dhe Japonia i vënë sanksione të reja Moskës

Australia dhe Japonia kanë shtuar sanksionet ndaj Moskës.

Kanbera ka shtuar miliardë të rusë, Oleg Deripaska dhe Viktor Vekselberg, si dhe 11 banka dhe subjekte qeveritare në listën e sanksioneve. "Me përfshirjen e Bankës Qendrore të Rosisë, Australia tani ka shënjestruar të gjitha subjektet e mundshme të Qeverisë së Rosisë, të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit sovran të Rosisë", ka thënë ministrja e Jashtme kanadeze, Marise Payne, përmes një deklarate. Ndërkohë Tokio ka sanksionuar 15 rusë të tjerë dhe nëntë organizata, duke përfshirë kompaninë shtetërore të eksportimit të armëve, "Rosoboronexport".



Arrestohet ish-kryeministri bullgar Bojko Borisov

SOFJE, 18 MARS - Ish-kryeministri i Bullgarisë, Bojko Borisov, është arrestuar të enjten, më 17 mars, pas një operacioni policor të lidhur me hetimet e zyrës së prokurorit të BE-së, ka njoftuar Ministria e Brendshme e Bullgarisë.

Në njoftimin e ministrisë është thënë se bashkë me Borisovin janë arrestuar edhe ish-ministri i Financave, Vladislav Goranov, ish-shefi i komisionit parlamentar buxhetor, Menda Stojanova dhe këshilltarja e Borisovit për medie, Sevdalina Arnaudov. "Një operacion në shkallë të gjerë është duke u zhvilluar në Bullgari në lidhje me 120 raste të Prokurorisë Evropiane. Bastisje dhe sekuestime janë kryer në shumë adresa. Bojko Borisov, Vladislav Goranov, Menda Stojanova dhe Sevdalina Arnaudova aktualisht janë të ndaluar", është thënë në njoftim.

Borisov, 62 vjeç, është aktualisht

kryetar i partisë opozitare të qendrës së djathtë GERB. Ministria nuk ka dhënë hollësi, por televizioni publik BNT ka njoftuar se rastet kishin të bënin me "keqpërdorimin e ndihmave të BE-së".

Bastisjet kanë vazhduar në shumë adresa në të gjithë vendin. "Askush nuk është mbi ligjin", ka thënë kryeministri i ri i Bullgarisë, Kiril Petkov, në një shkrim të publikuar në rrjetet sociale. Partia e sapoformuar kundër korrupsionit e Petkovit ka fituar zgjedhjet e përgjithshme në Bullgari vitin e kaluar, me platformën "zero tolerancë për korrupsionin".

Operacioni vjen pas një vizite në Sofje më 16-17 mars nga kryeprokurorja evropiane Laura Koevesi. Ajo ka vlerësuar "vendosmërinë, udhëheqjen dhe vizionin bindës të Petkovit në luftën kundër korrupsionit". "Tani është koha që autoritetet përkatëse bullgare të bashkohen me ne, duke përfshirë rastet



veçanërisht të ndjeshme. Kjo është arsyeja pse ne ekzistojmë, kjo është arsyeja pse jemi këtu", ka thënë Koevesi, i cili ka bërë me dije se janë hapur 120

hetime për mashtrime që përfshijnë paratë e BE-së në lidhje me tenderët publikë, subvencionet bujqësore, ndërtimet dhe fondet e

rimëkëmbjes nga pandemia e koronavirusit.

Borisov është akuzuar për korrupsion disa herë gjatë viteve, por i ka mohuar akuzat.

KANCELARI I AUSTRISË VIZITON KOSOVËN, PRITET ME NDERIME
SHTETËRORE NGA KRYEMINISTRI KURTI

Austria kërkon të përshpejtohet procesi i anëtarësimit të Kosovës në BE

- Kancelari austriak: Do të jetë e rëndësishme për ne që edhe Gjermaninë ta përfshijmë në përshpejtimin e anëtarësimit të Kosovës në BE



Kancelari i Austrisë, Karl Nehammer, i ka dhënë mbështetje Kosovës për anëtarësimin në Bashkim Evropian (BE). Në një konferencë të përbashkët për medie me kryeministrin Albin Kurti, ai ka thënë se do të angazhohet personalisht për integrimin e Kosovës në BE dhe për liberalizimin e vizave. Kancelari austriak ka thënë se procesin eurointegruës do ta përshpejtojë edhe me Gjermanisë, e cila është aleate e madhe e Kosovës. Ndërsa kryeministri Kurti ka kërkuar ndihmën e Austrisë për rritjen e fondeve të BE-së për Kosovën. Gjithashtu, Kurti ka kërkuar ndihmën e Austrisë edhe për liberalizimin e vizave dhe anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës

edhe për përshpejtimin e agjendës për integrimin e Kosovës në BE. "Qeveria jonë është e orientuar drejt reformave për t'i pambushur të gjitha kriteret që na ofrojnë sa më shumë në Bashkimin Evropian. E sigurova kancelarin se Kosova vazhdon të mbetet partnere e qëndrueshme dhe e besueshme. Sikurse për refugjatët afganë, kemi ofruar ndihmën tonë edhe në rastin e Ukrainës. U jemi bashkuar sanksioneve kundër Rusisë dhe kemi shprehur gatishmërinë për të ofruar kushte të punës për 20 gazetarë ukrainas dhe gatishmëri për strehim të deri 5 000 refugjatëve", është shprehur Kurti, duke treguar edhe kërkesat e tjera që ia ka parashtruar kancelarit të Austrisë.

Kurti ka thënë se ka kërkuar mbështetjen e Austrisë për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës (KE) dhe shtyrjen përpara të procesit të liberalizimit të vizave. "Potencova rëndësishme e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës si dhe përshpejtimin e agjendës së integritetit drejt anëtarësimit në BE. Nga kancelari kërkova që Austria ta shtyjë përpara vendimin për liberalizimin e vizave në Këshillin Evropian të BE-së, sepse ky është një vendim i vonuar që po i dëmton jo vetëm qytetarët, por edhe bizneset dhe ekonominë e Kosovës", ka thënë Kurti.

Pas takimit me Kurtin, kancelari i Austrisë është takuar edhe me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani.

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 MARS - Kancelari i Austrisë, Karl Nehammer, ka qëndruar për vizitë zyrtare në Republikën e Kosovës. Gjatë kësaj vizite ai është pritur me ceremoni shtetërore nga kryeministri Albin Kurti. Pas takimit kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për medie. Në konferencë kancelari austriak i ka dhënë mbështetje Kosovës për anëtarësimin në Bashkim Evropian (BE), duke thënë se do të angazhohet personalisht për këtë proces. Po ashtu, ai ka thënë se është koha që Kosovës t'i liberalizohen vizat. Në këtë kontekst, kancelari austriak ka thënë se procesin eurointegruës do ta përshpejtojë edhe me Gjermaninë si aleate e madhe e Kosovës. "Edhe kryeministri e përmendi që Austria do të jetë urë lidhëse me BE-në. Kemi zhvilluar biseda të mira se si mund ta përshpejtojë procesin, prandaj do të jetë e rëndësishme për ne që edhe Republikën Federale të

Gjermanisë ta përfshijmë, sepse edhe ata janë miq të Kosovës dhe bashkë e përshpejtojmë anëtarësimin në BE. Besoj se bashkë do t'ia dalim, sepse për Austrinë Ballkani Perëndimor është një pikë gjeostrategjike dhe gjeopolitike", ka thënë Nehammer, duke shtuar se Kosova dhe Austria kanë lidhje të përbashkët historike. "Kemi lidhje historike me njëri-tjetrin dhe është e rëndësishme që edhe në të ardhmen të jemi të lidhur së bashku. Për këtë Kosova duhet të jetë brenda Bashkimit Evropian dhe për këtë duhen perspektiva të mëdha", ka thënë ai. Më tutje, Nehammer ka thënë se i di problemet e Kosovës me Serbinë, por se duhet të shikohet kah e ardhmja. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka kërkuar nga kancelari i Austrisë, Karl Nehammer, që Bashkimi Evropian (BE) t'i rrisë fondet për Kosovën pasi, siç ka thënë, shteti austriak ka ndikim të madh në BE. "Austria ishte rreze shprese për ne gjatë okupimit si dhe ndër shtetet e pra që e njohu shtetin e Kosovës dhe hapi ambasadën në shtetin tonë.

Sikurse për refugjatët afganë, i kemi ofruar ndihmën tonë edhe Ukrainës dhe kemi shprehur gatishmërinë për të pranuar dhe për të ofruar kushte të punës për 20 gazetarë ukrainas", ka thënë Kurti.

Në këtë konferencë të përbashkët për medie Kurti ka thënë se me kancelarin austriak ka biseduar





I bëhet thirrje qeverisë që ta nisë aplikimin për anëtarësim në Këshillin e Evropës

Përkundër se janë bërë 14 vjet që nga shpallja e pavarësisë, Kosova vazhdon të mbetet jashtë prej disa organizatave më të rëndësishme ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe Këshillin e Evropës. Me përjashtimin e Rusisë nga ky institucion janë shtuar zërat për shtimin e procedurave për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës. Ditë më parë edhe raportuesja e Parlamentit Evropian, Viola von Cramon, ka thënë se e mbështetë plotësisht aplikimin që Kosova të bëhet pjesë e Këshillit të Evropës

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 18 MARS - Në ditën që Këshilli i Evropës zyrtarisht e ka përjashtuar Rusinë janë shtuar zërat për shtimin e procedurave për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se janë në kontakte të ngushta me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës për këtë çështje. "Tashmë unë mendoj se është momenti. Që nga zgjedhja ime presidente dhe si

udhëheqëse e politikës së jashtme kam insistuar që Këshilli i Evropës të jetë prioritet mbi prioritet sa i përket organizatave ndërkombëtare. Jemi duke punuar shumë afër me ministrin e Punëve të Jashtme e cila ka përgatitur strategjinë, mënyrën si shkon procedura, që fillimisht të dërgohet aplikacioni, kërkesa pastaj Këshilli i Evropës emëron të deleguar që të vijnë në Kosovë për ta vlerësuar plotësimin e kriterëve në fushat e ndryshme", ka thënë Osmani.

Ish-ministri i Jashtëm, Enver Hoxhaj, ka thënë se përjashtimi i Rusisë nga Këshilli i Evropës le t'i paraprijë anëtarësimin të Kosovës në këtë institucion. "Mundësi të tilla të arta nuk injorohet, por shfrytëzohen! Është koha që Kosova të aplikojë, jo nesër, por sot!", ka shkruar Hoxhaj në "Facebook". Edhe kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se largimi i Rusisë nga Këshilli i Evropës përbën një mundësi reale për Kosovën. Ai ka theksuar se pengesat kryesore që ka pasur Kosova për vite me radhë për tentimin e saj për anëtarësim në këtë organizatë shumë të rëndësishme, fatmirësisht janë eliminuar me largimin e Rusisë. "Kjo mundësi e re, ky momentum vendimtar, nuk po shfrytëzohet si duhet nga institucionet e shtetit të Kosovës. Ky rast që i është paraqitur Kosovës, nuk duhet të kalojë pa u kapitalizuar. Institucionet e shtetit duhet të nisin menjëherë dhe pa humbur kohë një fushatë

lobimi dhe koordinimi me aleatët tanë strategjikë për të planifikuar dhe përcaktuar hapat drejt aplikimit dhe anëtarësimin në Këshillin e Evropës. Anëtarësimi i Kosovës në KE do të ishte një hap më tej drejt fuqizimit të shtetësisë, por edhe fundamental për forcimin e demokracisë, sundimit të ligjit dhe bashkëpunimit në familjen evropiane e më gjerë", ka thënë Krasniqi.

Ai ka shtuar se qasja në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut në Strasburg, aty ku zbatohen parimet e drejtësisë së Kartës Evropiane të Drejtave të Njeriut, e cila edhe ashtu është e inkuadruar brenda Kushtetutës së Republikës së Kosovës, do të ishte përfitim i madh për qytetarët dhe shtetin tonë. "Prandaj, kjo situatë e re e krijuar, që rritë shanset e Kosovës për pranim në Këshillin e Evropës, duhet të shndërrohet në agjendë me prioritet shtetëror dhe të

trajtohet në mënyrë emergjente - duke u ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm që mundësojnë anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare. Qeveria nuk duhet ta humbasë këtë rast. Partia Demokratike e Kosovës, si lidere e opozitës, është e gatshme që të japë të gjithë kontributin e saj në këtë proces të rëndësishëm së madhe për shtetin tonë", ka deklaruar Krasniqi.

Edhe raportuesja e Parlamentit Evropian, Viola von Cramon, ka thënë se e mbështetë plotësisht aplikimin që Kosova të bëhet pjesë e Këshillit të Evropës. Cramon ka deklaruar se Kosova dhe qytetarët e saj meritojnë qasjen në mekanizmat e Evropës. "Unë e kam mbrojtur këtë për një kohë të gjatë dhe kështu jam dakord me propozimin e Qeverisë së Kosovës për të aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Qytetarët e Kosovës meritojnë qasje të plotë në mekanizmat më të vjetër të

Osmani: Marrëdhëniet e Kosovës me ShBA-në janë ekzistenciale dhe strategjike

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të premten në takim një delegacion nga Shtëpia e Bardhë. Ky delegacion udhëhiqej nga Elizabeth Sherwood-Randall, këshilltare për siguri kombëtare e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Joe Biden. Pas këtij takimi, presidentja Osmani në "Facebook" ka shkruar se marrëdhëniet e Kosovës me ShBA-në janë ekzistenciale dhe strategjike. "Jam krenare për shtimin e bashkëpunimit tonë me Shtetet e Bashkuara të

Amerikës. Jemi të vendosur për t'i forcuar më tej marrëdhëniet tona politike, ushtarake dhe ekonomike, prandaj sot pata nderin ta mirëpres në takim një delegacion nga Shtëpia e Bardhë, të udhëhequr nga znj. Elizabeth Sherwood-Randall, këshilltare e presidentit Biden. Marrëdhëniet me ShBA-në janë ekzistenciale dhe strategjike!", ka shkruar Osmani.

Delegacioni nga Shtëpia e Bardhë, i cili shoqërohej nga ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, është takuar edhe me kryeministrin Albin Kurti.



Theodora Bakoyannis zgjedhet raportuese për Kosovën në Asamblenë Parlamentare të KE-së



STRASBURG, 18 MARS (ER) - Komiteti për Çështje Politike dhe Demokraci në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) në Strasburg të Francës, ka zgjedhur Theodora Bakoyannis raportuese për Kosovën në Asamblenë

Parlamentare të Këshillit të Evropës, e cila është edhe kryesuese e delegacionit të Greqisë në APKE.

Pas konfirmimit të rezulttit, tashmë e zgjedhura, Theodora Bakoyannis, ka falënderuar anëtarët e këtij komiteti për

besimin e dhënë dhe ka shtuar se do ta përgatisë raportin për Kosovën. Ndër të tjera ajo ka thënë se është koha që rajoni dhe Kosova të integrohen në Bashkimin Evropian dhe në mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë.

Bakoyannis ka qenë ministre e Punëve të Jashtme të Greqisë, si gruaja e parë më pozitive të lartë në Greqi dhe ka një karrierë të bujshme politike, që e bëjnë njohëse të mirë të rrethanave në Ballkan. Para saj raportues për Kosovën

në APKE ka qenë deputeti i Bundestagut Gjerman, Peter Beyer. Delegacioni i Kuvendit të Kosovës ka mirëpritur zgjedhjen e Bakoyannisit dhe është zotuar se do të bashkëpunojë ngushtë me të për procesin e hartimit të raportit për Kosovën.

Evropës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duke përfshirë #ECHR #ECtHR", ka shkruar Cramon para pak ditësh në llogarinë e saj në "Twitter".

Instituti GAP ka bërë me dije se përfitimet e anëtarësimit në Këshillin e Evropës janë më shumë politike sesa që janë ekonomike, ligjore apo sociale. "Anëtarësimi i Kosovës në KE rrit mundësinë që Kosova t'i mbrojë qytetarët e saj të cilët kanë probleme të natyrave të ndryshme në vendet jashtë Kosovës e që

janë anëtare të KE-së. Gjithashtu, shtetasit e Kosovës do të mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse konsiderojnë se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre nga shteti i Kosovës, apo cilido shtet anëtar i KE-së. Mirëpo kjo mund të arrihet vetëm kur të jenë shtetur të gjitha mundësitë ligjore kombëtare, te atëherë qytetarët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjithashtu, pjesëmarrja e përfaqësuesve

kosovarë në kuadër të KE-së do ta rriste prestigjin ndërkombëtar të shtetit të Kosovës dhe do të mund të ndikojë që opinionet e Asamblesë Parlamentare dhe Këshillit të Ministrave të KE-së të jenë më të favorshme për Kosovën", thuhet në raportin e publikuar nga GAP-i. Gjithashtu, në raport janë sqaruar edhe procedurat që duhen ndjekur që Kosova të bëhet pjesë e Këshillit të Evropës. "Duke marrë parasysh përfitimet që mund të ketë Kosova nga

anëtarësimi në KE, po ashtu duke marrë në konsideratë kushtet që plotëson Kosova për të qenë anëtare e KE-së, si dhe fakti që një numër i arsyeshëm i konventave të KE-së aplikohen në forma të ndryshme në Kosovë, Kosova sa më parë duhet ta shqyrtojë mundësinë e anëtarësimit në KE. Rregullat statutorë të KE-së nuk parashohin hapa konkretë rreth procedurave të pranimit të shteteve të reja anëtare në KE. Hapat konkretë të anëtarësimit të shteteve të reja nuk mund të gjenden as

në dokumentet bazë të KE-së siç janë: Statuti i KE-së, Rregullat e Punës të Këshillit të Ministrave, Rregullat e Punës të Zëvendësve në Këshillin e Ministrave, si dhe Rregullat e Punës të Asamblesë Parlamentare të KE-së", theksohet në raportin e GAP-it. Në planprogramin e Qeverisë së Kosovës, e cila është formuar në mars të vitit të kaluar, thuhet se "rëndësi të posaçme për Republikën e Kosovës paraqet anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe kultivimi i fqinjësisë së mirë".

Lirohen nga pagesa e trafikut urban nxënësit, policët dhe zjarrfikësit

PRISHTINË, 18 MARS (ER) - Policia e Kosovës, zjarrfikësit dhe nxënësit e shkollave fillore të komunës së Prishtinës janë liruar nga pagesat e

përdorimit të trafikut urban është bërë me dije në një njoftim të komunës së Prishtinës. "Policia e Kosovës, zjarrfikësit dhe nxënësit e

shkollave fillore të komunës së Prishtinës lirohen nga pagesat e përdorimit të trafikut urban. Ky vendim u mor në shenjë falënderimi për punonjësit e

linjës së parë dhe për ta stimuluar përdorimin e transportit publik te generatat e reja", ka njoftuar komuna e Prishtinës.



Nis punën për herë të parë Shërbimi Stomatologjik Pediatric në Skenderaj

SKENDERAJ, 18 MARS (ER) - Ka nisur punën për herë të parë Shërbimi Stomatologjik Pediatric në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Skenderaj, pas përpjekjeve të vazhdueshme të qeverisjes lokale për funksionalizim të shërbimeve në spitalin e qytetit. Për të parë punën dhe interesimin e fëmijëve për t'i kontrolluar dhe mjekuar dhëmbët, kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura dhe drejtori për Arsim, Kastriot Duraku, i cili ka dhënë kontribut për angazhimin dhe përfshirjen e shkollave në këtë fushatë parandaluese të sëmundjeve orale, e kanë përgëzuar mjekët

stomatologë të QKMF-së për shërbimet e ofruara. Nura është shprehur i lumtur për fillimin e punës në repartin pediatric stomatologjik, ndërkohë që ka biseduar edhe me fëmijët që pritnin në radhë për t'i kontrolluar dhëmbët. "Ky shërbim po ofrohet për herë të parë, pas përpjekjeve tona për ta funksionalizuar çdo shërbim publik mjekësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Dhëmbët duhet të jenë të shëndoshë edhe te fëmijët, e për të arritur këtë nevojitet mjekim dhe ruajtje e shëndetit të tyre", ka thënë i pari i Skenderajt. Që prej se filloi mandatin, kryetari Nura është angazhuar për t'i funksionalizuar të gjitha



shërbimet spitalore dhe shkurtuar radhët e pacientëve për të marrë shërbime mjekësore. Gjatë kësaj

kohe janë funksionalizuar disa shërbime në radiologji, duke e vënë për herë të parë aparat

mamografik dhe pajisje të tjera të nevojshme për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme.

Ambasadori gjerman viziton Gjilanin, ofron bashkëpunim në disa projekte

GJILAN, 18 MARS (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde. Hyseni ka bërë me dije se një nga temat kryesore të takimit ka qenë fusha e ambientit dhe e menaxhimit të mbeturinave. "Një prej temave kryesore që kemi diskutuar është fusha e ambientit dhe e menaxhimit të mbeturinave, pasi që partner i afërt i bashkëpunimit tonë është edhe organizata gjermane GIZ. Kemi biseduar hollësisht për mundësitë e bashkëpunimit në mes të



komunës së Gjilanit dhe, potencialisht, të ndonjë qyteti të

Gjermanisë, ku ne i marrim praktikën dhe të njëjtat i

implementojmë në Gjilan", ka thënë Hyseni, duke shtuar se ambasadorin Rohde e ka njoftuar edhe për projektet të cilat janë duke zhvilluar tash në Gjilan, duke filluar prej zonës ekonomike dhe agro-turizmit.

Ndërsa ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, ka falënderuar kryetarin Hyseni për pritjen dhe ofrimin e gatishmërisë së bashkëpunimit, duke shtuar se mezi pret që të jenë partnerë të komunës në projekte si: menaxhimi i mbeturinave, zhvillimi turistik apo zhvillimi ekonomik. "Për mua ishte hera e

parë që e vizitoj Gjilanin. Siç na informoi edhe kryetari për projektet në vazhdim dhe sfidat për qytetin, unë mora disa lajme që nuk i dija më parë, që ju keni edhe atraksione turistike në zonën tuaj, një kala të cilën ndoshta do ta vizitohet shpejt. Edhe zhvillimi ekonomik është shumë i rëndësishëm, veçanërisht që të rinjtë e Gjilanit të qëndrojnë këtu. Kuptova, gjithashtu, se keni plane shumë ambicioze për të krijuar hapësira urbane në qytet, së bashku edhe me institucionet gjermane", ka deklaruar ambasadori Rohde pas takimit.

UShAF-i nënshkruan marrëveshje për shkëmbim të studentëve me Universitetin e Sapienzas



FERIZAJ, 18 MARS (ER) - Rektori i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Agron Bajraktari dhe Antonella Polimeni, rektore e Universitetit të Sapienzas në Romë të Italisë, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbim të studentëve.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shërben për përmirësim të kurrikulës së studentëve përmes shkëmbimit të përvojave jashtë vendit.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje universitetet zgjedhin studentët e tyre për të marrë pjesë në programin e studimeve jashtë vendit sipas

kritereve të paracaktuara. Kohëzgjatja e shkëmbimit nuk do të jetë më e shkurtër se tre muaj dhe as të kalojë një vit akademik.

Për kohëzgjatjen e shkëmbimit, si dhe për kushtet për të cilat do të propozohen, do të merren vesh sipas nevojave dhe kërkesave të palëve.

Plotësohen me sinjalizim disa rrugë në komunën e Drenasit

DRENAS, 18 MARS (ER) - Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe e Emergjencës në Drenas, në bazë të planit të punës, ka bërë plotësimin me

sinjalizim në rrugët e kësaj komune, duke i pajisur me shenja të sinjalizimit. Shenjëzimi i duhur, përveç që ndihmon në orientim, është i

rëndësishëm edhe për sigurinë e të gjithë pjesëtarëve të trafikut. Me këtë rast drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë,

Lumnije Gjoshi-Krapi, ka theksuar se do të vazhdojnë të punojnë për ofrimin e shërbimeve më të mira për sigurinë e udhëtarëve.



Kelmendi: Nëse paga minimale do të ishte 700 euro askush nuk do të ikte nga Kosova

PRISHTINË, 18 MARS - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Ramiz Kelmendi, ka thënë se kryeministri i Kosovës do të duhej ta kishte pagën mbi 5 000 euro. Ai ka treguar arsyet se pse kreu i ekzekutivit të vendit do të duhej ta ketë një pagë të tillë.

Kelmendi ka theksuar se, sipas kësaj matematike, do të rregullohej edhe paga

minimale në vend, e cila do të duhej të bëhej 700 euro, e kjo do të ndikonte edhe te të rinjtë që të mos e braktisin Kosovën. “Paga e kryeministrit dhe presidentit është mizore. Çfarë do të bëjë kryeministri me atë pagë? Kryeministri duhet ta bëjë një pushim të mirë. Atij [kryeministrit] do të duhej t’i garantohej një pagë në vlerë prej 5 mijë

eurosh. Kryeministri krijon politika dhe i mban krejt politikat ekonomike të një shteti. Nëse kryeministri e ka pagën 5 mijë euro, atëherë kam për të tentuar që paga minimale mos të jetë më pak se 700 euro. Nëse paga minimale do të ishte 700 euro askush nuk do të ikte nga Kosova”, ka thënë Kelmendi për “Kanal10”.



Arbitrazhi dhe ndërmjetësimi, mundësi për bizneset për zgjidhjen e kontesteve

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 MARS - Mekanizmat alternativë për zgjidhjen e kontesteve siç janë arbitrazhi dhe ndërmjetësimi përbëjnë një mundësi për bizneset për shkak të efikasitetit dhe përfitimeve të tjera, prandaj duhet inkurajuar përdorimi i tyre në Kosovë. Rëndësia e shfrytëzimit të përfitimeve të arbitrazhit ishte në fokus të aktivitetit që shënoi edhe përfundimin e Javës së Arbitrazhit të organizuar bashkërisht nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programi për Drejtësi Komeriale i Agjencisë së

Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Deputetja e Kuvendit të Kosovës, Dorasa Kica-Xhelili, ka thënë se politikëbërësit në Kosovë duhet ta njoftojnë elektoratin e tyre lidhur me mundësitë alternative të zgjidhjes së konfliktit në Kosovë. Ajo ka thënë se edhe pse gjyqësori i Kosovës njihet për zvarritjen e rasteve, është e rëndësishme që politikanët t’i njoftojnë bizneset dhe investitorët potencialë që Kosova ka kapacitete shumë të mëdha të metodave alternative të zgjidhjes së kontesteve. “Parashikueshmëria e kohëzgjatjes për zgjidhje të

kontestit dhe mundësia e zgjedhjes së arbitrave ofron komoditet te palët që të besojnë se gjykimi është i paanshëm”, ka thënë deputetja Kica-Xhelili, e cila ka elaboruar përfitimet e arbitrazhit.

Chris Thompson, udhëheqës i programit të USAID-it për Drejtësi Komeriale, ka thënë se bizneset kanë nevojë për metoda të shpejta dhe finale prandaj, si i tillë, arbitrazhi mund të jetë alternativë me shumë përfitime për bizneset. Megjithatë, ai shtoi se arbitrazhi nuk përdoret mjaftueshëm.

Në vazhdim ai tha se po punohet që bizneset ta njohin këtë metodë

si mundësi alternative ndaj sistemit gjyqësor dhe të jenë të vetëdijshëm për avantazhet që i ka kjo alternativë.

Tea Blakaj, këshilltare e jashtme ligjore e kryeministrit të Kosovës, ka thënë se duke qenë se kontestet komerciale që trajtohen në gjykata hasen në zvarritje dhe jo profesionalizëm, arbitrazhi si metodë alternative e zgjidhjes së kontesteve është më i leverdishëm për bizneset. Ajo ka shtuar se krijimi i gjykatës komerciale do të shërbejë edhe për fuqizimin e mekanizmave alternative për zgjidhjen e kontesteve.

Gjatë Javës së Arbitrazhit 2022,

nga mbi pesëmbëdhjetë profesionistë të arbitrazhit në veçanti dhe të fushës ligjore në përgjithësi, janë trajtuar aspekte të ndryshme të arbitrazhit siç është njohja e aktvendimeve të arbitrazhit, si dhe proceset dhe implikimet e rasteve të arbitrazhit, ndërsa në mënyrë të veçantë është folur edhe për rolin e grave profesioniste në arbitrazh. Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Programi i USAID-it për Drejtësi Komeriale do ta vazhdojnë promovimin e përfitimeve të mekanizmave alternative për zgjidhjen e kontesteve siç janë arbitrazhi dhe ndërmjetësimi.



Jashari: Paga minimale të ngrihet edhe për kategoritë e dala nga lufta

Prishtinë, 18 mars - Kryetari i Shoqatës së Familjarëve të Dëshmorëve të UÇK-së, Xhavit Jashari, ka kërkuar që edhe kategoritë e personave të dala

nga lufta të përfshihen në ngritjen e pagës minimale. Sipas tij, kjo ngritje duhet të jetë në shumën rreth 500 euro, në mënyrë që ata të cilët kanë

kontribuar për vendin, të kenë mundësi të bëjnë një jetë të dinjitetshme. Këtë deklaratë Jashari e ka bërë në emisionin “NewsTalkme Dafinën” në Klan

Kosova FM. Ai ka thënë se nëse nuk ndodh ngritja e pagës minimale do të dalin edhe në protesta për ta kërkuar të drejtën e tyre që u takon edhe me ligj.



Qeveria i konsideron sekrete dhe nuk flet për rezervat



PRISHTINË, 18 MARS - Mielli dhe prodhimet e miellit, ilaçet, produktet higjienike, si dhe nafta, janë produktet kryesore që përbëjnë rezervat shtetërore të Kosovës. Ato mund të përdoren në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme si pasojë e katastrofave natyrore, luftërave apo edhe krizave në furnizim, thotë një nga themeluesit e rezervave shtetërore të Kosovës, Shaban Halimi, tashmë në pension.

Lufta në Ukrainë dhe pengesat në zinxhirin furnizues shkaktuan panik në disa prej vendeve të Ballkanit, përfshirë edhe Kosovën, ku javëve të fundit u rrit kërkesa për blerje të miellit dhe vajrave. Kjo situatë nxiti edhe debat se a ka Kosova rezerva të mjaftueshme.

Rezervat shtetërore të Kosovës janë themeluar në vitin 2012.

Halimi, që ka ushtruar pozitën e drejtorit të rezervave shtetërore, shpjegon se vendimi për t'i krijuar rezervat shtetërore të Kosovës ishte marrë pas rrethimit të një orteku bore në fshatin Restelicë në komunën e Dragashit. Në këtë tragjedi kishin vdekur dhjetë persona. Edhe pse kanë kaluar më shumë se dhjetë vjet nga tragjedia e Restelicës, Halimi thotë se rezervat shtetërore të Kosovës nuk janë zhvilluar sa duhet. Ai thotë se në rast të ndonjë gjendjeje të jashtëzakonshme natyrore apo agresioni ushtarak, Kosovës i mbarojnë rezervat shtetërore për një periudhë prej dhjetë ditësh. "Qeveria duhet të reflektojë dhe ta kuptojë rolin dhe rëndësinë e rezervave shtetërore që mund të kenë ato në rast të agresionit,

fatkeqësive natyrore e, mos dhëntë Zoti, edhe në rast të ndonjë luftime", ka theksuar Halimi, i cili i rekomandon qeverisë ta rrisë sasinë e rezervave, nisur nga produktet bazike për jetesë. "Qeveria duhet ta rrisë sasinë e miellit si produkt kryesor. Të ketë miell për periudhë sa më të gjatë. Pastaj naftën, sepse nafta paralizon jetën në përgjithësi, e pastaj vijnë produktet e tjera ushqimore të gatshme siç janë pastat, kripa, sheqeri, vaji e të tjera, mjetet higjienike, por asesi nuk duhet përjashtuar ujin sepse është produkt kryesor për jetën", ka thënë Halimi.

Edhe pse nuk ka të dhëna zyrtare publike nga institucionet, sa i takon sasisë së grurit, në Shoqatën e Mullisëve të Kosovës thonë se sasia e grurit në dispozicion mbulon nevojat për më së shumti tre muaj. "Në Kosovë duhet të jenë diku edhe 40 mijë deri në 50 mijë tonë grurë pa i marrë parasysh rezervat e fermerëve që janë nëpër shtëpitë e tyre. Unë mendoj se ka sasi të madhe te fermerët, sepse po e shohim kohëve të fundit se është rritur kërkesa për shitje të grurit nga fermerët, sepse ka çmim të leverdishëm dhe ata janë të interesuar ta shesin", ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë",

Bashkim Zejnullahu, drejtues i Shoqatës së Mullisëve të Kosovës. Kërkesa për grurë për kokë banori në Kosovë sillet rreth 200 kilogramë, ose në total rreth 400 mijë tonë grurë në vit. Sasia e saktë, lloji i produktit dhe vendndodhja e mallrave që janë

Ku janë të vendosura rezervat shtetërore të Kosovës?

Ato nuk janë në depo e as magazina në pronësi të institucioneve të Kosovës. Shteti nuk ka depo e as magazina të tilla pasi, sipas ekspertëve, kjo do të kërkonte investime të mëdha financiare dhe burime njerëzore. Për këtë arsye rezervat janë tek operatorët ekonomikë privatë, të cilët kontrahohen nga Departamenti i Rezervave Shtetërore. Sipas Ligjit për Rezervat Shtetërore, në bazë të marrëveshjes, atyre u përcaktohen sasisë, mënyra e ruajtjes dhe kontrollit, si dhe dalja në treg e këtyre produkteve. Si me produktet ushqimore dhe higjienike, e njëjta procedurë vlen edhe për naftën dhe produktet e saj.

Nafta aktualisht ruhet tek operatorët ekonomikë privatë, të cilët kanë rezervuarë në dispozicion. Ata kontrahohen nga institucionet e Kosovës dhe kanë për obligim sigurimin e cilësisë, sigurisë dhe mirëmbajtjes.

Qeveria aktualisht është duke punuar për rregullimin e rezervave të detyrueshme të

naftës. Projektligji që rregullon këtë aspekt është në konsultim publik.

Sipas projektligjit, për ruajtjen e rezervave shtetërore të Kosovës i jepet përparësi ruajtjes së rezervave në territorin e Kosovës, edhe pse një sasi mund të ruhet në territorin e një shteti anëtar të BE-së ose anëtarit të Traktatit të Komitetit të Energjisë me marrëveshje dypalëshe.

Ky projektligj ka gjetur mbështetjen e Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, thotë Fadil Berjani, kryetar i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës. "Rezervat e naftës nuk do të dërgohen vetëm te një operator ekonomik. Rezervat shtetërore do të ndahen në tërë territorin e Kosovës në mënyrë të barabartë", thotë Berjani.

Bazuar në projektligjin e ri, rezervat e detyrueshme do të mbahen në objekte deponuese dhe do të jenë të gatshme ose fizikisht të qasshme gjatë gjithë kohës në përputhje me kontratën e deponimit.

Kompania që mban rezervat e detyrueshme duhet ta bëjë këtë në përputhje me legjislacionin

përkates për cilësinë e produkteve të naftës në Kosovë dhe Departamenti i Rezervave Shtetërore do të ketë qasje të pakufizuar për verifikimin e cilësisë dhe kushteve të tjera të kontratës, thuhet në projektligjin që pritet të shkojë për votim në Kuvendin e Kosovës.

Pas shfaqjes së luftës në Ukrainë, zyrtarët e Qeverisë së Kosovës ftuan qytetarët të mos krijojnë stoqe të produkteve në shtëpitë e tyre.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, më 26 shkurt thase vitin e kaluar, por edhe këtë vit shteti ka blerë naftë, miell, produkte ushqimore dhe higjienike, por duke mos specifikuar ndonjë periudhë kohore për të cilën ato do të mjaftonin.

Njëjtë edhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, më 26 shkurt ka thënë se Kosova është e furnizuar mirë dhe se ka rezerva të mjaftueshme. Për t'i shtuar rezervat, Qeveria e Kosovës ndau 10 milionë shtesë më 23 shkurt.

në kuadër të rezervave shtetërore nuk dihet. Ato konsiderohen 'sekret shtetëror' sipas Ligjit për rezervat shtetërore.

Rezervat menaxhohen nga Departamenti i Rezervave Shtetërore, që funksionon në kuadër të Ministrisë së

Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).

Zyrtarët e kësaj ministrie nuk kanë pranuar të flasin për sasinë e as organizmin e rezervave shtetërore, me arsyetimin se ato konsiderohen 'sekret shtetëror'. MINT-i ka përcjellë një vendim të nënshkruar nga kryeministri i

Kosovës, Albin Kurti, përmes të cilit është "aprovuar kërkesa e Departamenti të Rezervave Shtetërore që t'u mundësohet përjashtimi nga procedurat e prokurimit për furnizim me produkte të rezervës shtetërore të mallrave, duke e klasifikuar lëndën e kontratës si sekret".

Gjashtë gjërat që mund të bëjë tani NATO, për të ndihmuar Ukrainën

Nga David A. DEPTULA, Marc R. DeVore, Emma SALISBURY & Michael HUNZEKER
"ForeignPolicy"

Lufta brutale e Rusisë në Ukrainë, paraqet një dilemë të madhe për politikë-bërësit perëndimorë. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë ushtarake rrezikon një përshkallëzim të papranueshëm të konfliktit, veçanërisht për anëtarët e NATO-s.

Por edhe lejimi i agresionit rus kundër një demokracie evropiane do të ketë pasojë shkatërruese afatgjata për popullin ukrainas, sigurinë evropiane, dhe të gjithë konceptin e një rendi ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Kërcënimi me sanksione ekonomike të mëdha, nuk arriti që ta pengonte sulmin e Rusisë.

As zbatimi i shpejtë dhe gjithëpërfshirës i tyre, nuk duket se do ta detyrojë presidentin rus Vladimir Putin të braktisë fushatën e tij ushtarake. Prandaj NATO duhet të ndërmarrë më shpejtësi veprime që do të ndihmojnë forcat konvencionale të Ukrainës të shmangin humbjen, që i shkaktojnë kosto më të rënda ushtrisë ruse, që forcojnë pozitat e Kievit në tryezën e bisedimeve, dhe që i lënë kohë sanksioneve të japin efektet e tyre.

Mjerisht, opsioni i vendosjes së një zone të ndalim-fluturimit që ka nisur të mbështetet nga disa ish-zyrtarë ushtarakë të rangut të lartë dhe zyrtarëve të qeverive perëndimore, është shumë përshkallëzues, ndaj nuk ka gjasa të funksionojë. Fatmirësisht, NATO ka mundësi të tjera. Ja cilat janë 6 hapat, të cilat në mendojmë se mund të ndërmarrë aleanca në kushtet aktuale.

1. Trajnimi i vullnetarëve ukrainas, për të përdorur sistemet raketore të lëvizshme

Raketat janë jetike për të penguar sulmet ajrore dhe avancimin e tankeve. Ukraina ka mungesë të ekipeve të trajnuara për t'i përdorur këto armë. Vendet perëndimore mund ta plotësojnë këtë boshllëk duke trajnuar vullnetarët emigrantë ukrainas mbi sistemet raketore të lëvizshme nga njeriu, përpara se të rikthehen në vendlindje për luftuar.

Ashtu siç ka ndodhur me trajnimin që u kanë ofruar tashmë ushtritë perëndimore trupave ukrainase brenda vendit. Në fillim të Luftës së Yom Kipurit të vitit 1973, Izraeli nuk ishte asnjë raketë anti-tank.

Por sapo nisi lufta ambasada e Izraelit në Uashington mobilizoi studentët izraelitë që studionin në universitetet amerikane. Më pas ushtria amerikane i trajnoi sesi të përdornin raketat, dhe kur u dërguan në front shkatërruan shumë tanke armike, përpara se të përfundonte lufta pothuajse dyjavore.



2. Lehtësimi i aktiviteteve kibernetike civile

Grupet e hakerëve civilë, përfshirë grupin e njohur Anonymous, kanë filluar tashmë të synojnë në mënyrë të pavarur Rusinë dhe Bjellorusinë, duke shkatërruar faqet qeveritare të internetit, duke bërë publike dokumente të klasifikuara dhe duke hakeruar mediatshtetërore.

Këto sulme kibernetike janë sigurisht tërheqëse, por nuk kanë gjasa që ato të zbehin shumë fushatën ruse, sepse po ndërmerren nga një komunitet i lidhur me aktivistë kibernetikë që zotërojnë nivele të larta aftësisht teknike, por që nuk kanë njohuri kontekstuale për të maksimizuar dëmin e përpjekjeve të tyre.

NATO mund të ndihmojë në plotësimin e këtij boshllëku, duke gjetur mënyra për të "udhëhequr nga prapa", me synim koordinimin e sulmeve të tilla.

Por aleanca duhet të shmangë bashkëpunimin me grupime hakerash, që në parim ushqejnë ndjenja kundër qeverive. Po ashtu, vendet anëtare të NATO-s duhet të gjejnë mënyrat për t'i mbrojtur hakerat që veprojnë në territorin e tyre nga përgjegjësia ligjore dhe ndjekja penale nga Rusia dhe aleatët e saj.

3. Sigurimi i mjeteve ajrore luftarake pa pilot

Dronët ushtarakë turq "Bayraktar TB2" që përdor sot Ukraina, janë praktikisht e vetmja flotë ajrore me

të cilën ky vend po godet me sukses forcat tokësore ruse. Dhe kjo është e jashtëzakonshme duke pasur parasysh fuqinë ajrore që zotëron Rusia.

Duke pasur parasysh se sa të ç'organizuar janë kolonat e blinduara të Rusisë, dhe se sa e dobët po shfaqet mbrojtja e tyre ajrore me reze të shkurtër veprimi, furnizimi me më shumë dronë dhe municione, mund të bëjë diferencën në ndalimin e linjave të furnizimit dhe ngadalësimin e lëvizjeve ruse.

Çdo depo e furnizimit me karburant apo municione të krijuara nga rusët në tokën ukrainase, mund të jenë gjithashtu objektiva joshëse. Azerbajxhani përdori gjerësisht dronë gjatë luftës së Nagorno-Karabakut të vitit 2020, për të mposhtur ushtrinë armene të stilit rus. Ata shkatërruan sasi të konsiderueshme pajisjesh dhe autokolonash ushtarake armene, duke e çuar përfundimisht ushtrinë armene në një paralizë operacionale.

4. Zëvendësim i shpejtë i avionëve luftarakë ukrainas të humbur në betejë

Forcat Ajrore të Ukrainës kanë treguar një rezistencë të jashtëzakonshme, dhe vazhdojnë t'i mohojnë Rusisë epërsinë ajrore, gjë që e pengon aftësinë e kësaj të fundit për të kryer sulme ajrore dhe për të krijuar ura ajrore për të rifurnizuar forcat e saj tokësore në vijën e parë të frontit.

Megjithatë, Ukraina po pëson humbje të konsiderueshme, dhe ka të ngjarë të mbetet pa avionë përpara se t'i mbarojnë pilotët. Edhe pse mungojnë të dhënat e sakta, ka raporte se Ukraina ka humbur gati 10 për qind të 100 avionëve luftarakë që kishte në fillim të luftës.

Opsioni më i mirë është furnizimi me avionë që pilotët ukrainas dinë t'i përdorin: avionë luftarakë MiG-29 dhe Su-25. Për shembull, Polonia ka në dispozicion 28 MiG-29 që mund t'i transferojë menjëherë në Ukrainë. Ky opsion është bllokuar nga Shtetet e Bashkuara. Por një transferim i tillë mund të realizohet në heshtje, duke reduktuar edhe rrezikun e përshkallëzimit të situatës.

5. Rekrutim i pilotëve vullnetarë dhe ekipeve ndihmëse në tokë

Ky opsion paraqet një dilemë, pasi duhet një kohë e gjatë për të trajnuar pilotët dhe ekuipazhet e mirëmbajtjes, dhe këto role nuk mund të plotësohen lehtësisht nga vullnetarët vendas apo personeli ushtarak i një sektori tjetër.

Edhe pse NATO – dhe qeveritë e tjera perëndimore do të hezitojnë t'i furnizojnë drejtpërdrejt pilotët ushtarakë, ato ende mund të ndihmojnë në mënyra më pak shkallëzuese dhe më të diskrete, kryesisht duke trajnuar pilotët vullnetarë nga Evropa Lindore. Përpara se SHBA-ja të hynte zyrtarisht në Luftën e Dytë Botërore, presidenti i atëhershëm Franklin D. Roosevelt autorizoi pilotët e

Korpusit Ajror të Ushtrisë Amerikane, Marinës dhe Trupave Detare që të udhëtonin me avionë të prodhuar nga SHBA për Kinën, për të luftuar kundër Japonisë. 99 pilotët amerikanë u dorëhoqën zyrtarisht nga ushtria amerikane. Një model i ngjashëm mund të përdoret për të ndihmuar Ukrainën.

6. Mbështetja e vazhdimësisë së qeverisjes në Ukrainë

Vendimi i presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky për të qëndruar në Kiev dhe për ta mbrojtur kryeqytetin e tij, e fuqizoi rezistencën e Ukrainës, dhe fitoi mbështetje të gjerë ndërkombëtare. Por Rusia i ka dhënë përparësi kapjes apo vrasjes së udhëheqësve të lartë politikë dhe ushtarakë të Ukrainës.

Dhe forcat ruse mund ta arrijnë këtë gjë në betejën e tyre të ardhshme për pushtimin e Kievit. Prandaj, qeveria e Ukrainës duhet t'i njohë aleatët me një plan për vijimësinë e qeverisjes në çdo lloj skenari. Ukraina duhet të fillojë planifikimin për një rezistencë të vazhdueshme të organizuar nga një terren më i mbrojtur, me gjasë diku në malet Karpate në Ukrainën Perëndimore. Dhe shtetet perëndimore mund ta ndihmojnë duke ofruar këshilla për zbatimin, dhe lehtësimin e lidhjeve të komunikimit, si dhe dërgimin e pajisjeve dhe burimeve për të ndihmuar në forcimin e vendndodhjeve alternative të zgjedhura.

Marrë me shkurtimel/Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

“Final 4” i Ligës Unike, shpalosen hollësitë e organizimit

PRISHTINË, 18 MARS - Në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) është mbajtur konferencë për medie, duke shpalosur hollësitë për organizimin e Final 4 në konkurrencën e femrave. Ky është edicioni i parë dhe historik i kësaj gare, ndërsa do të organizohet në Prishtinë. Anëtarja e Bordit Drejtues të Ligës Unike, Elvira Dushku, ka thënë se kanë bërë përgatitjet e duhura për organizimin sa më të mirë të kësaj ngjarjeje të rëndësishme. “Liga Unike ka bërë të gjitha përgatitjet e duhura për organizimin e ‘Final 4’. Kjo është hera e parë që organizohet në konkurrencën e femrave, andaj duam që të jetë shembull edhe për herët e ardhshme dhe të jetë një

organizim i jashtëzakonshëm”, ka thënë Dushku. Vlora Braha, kryetare e Klubit të Prishtinës (femrat), ka dhënë hollësi për organizimin në kryeqytetin e Kosovës. “Ne jemi munduar të përgatitemi sa më mirë për ‘Final 4’ të Ligës Unike të femrat. Unë shpresoj se do të shijojmë dy ditë të basketbollit të femrat, duke parë ndeshje shumë të bukura në parket dhe një organizim madhështor. Kjo është hera e parë që e organizojmë dhe sigurisht se duam të fitojmë. Prishtina ka traditë në organizim dhe në fitimin e trofeve. Hyrja do të jetë falas dhe u bëjmë thirrje të gjithë adhuruesve të basketbollit që të vijnë në numër sa më të madh”, ka deklaruar Braha.

Ndërkohë, trajneri i Prishtinës, Fidan Shatri, ka folur sa iu përket pritshmërive të ekipit prishtinas për “Final 4”. “Ne jemi të nderuar që jemi pjesë e Ligës Unike dhe që për herë të parë do të organizojmë ‘Final 4’. Konkurrenca është shumë e fortë. Të katër skuadrat janë shumë të forta. Ne kemi bërë përgatitjet e duhura si ekip. Besoj se do të angazhohemi



ORARI

**Më 23 mars takohen:
16:00 Penza-Bashkimi
19:00 Prishtina-Flamurtari**

**Më 24 mars takohen:
16:00 Ndeshja për vendin e tretë
19:00 Ndeshja finale**

maksimalisht dhe të fitojmë këtë trofe”, ka deklaruar Shatri. Më pas është nënshkruar marrëveshja për Organizimin e “Final 4”, që do të mbahet më 23/24 mars në Prishtinë dhe

është paraqitur logoja zyrtare e kësaj ngjarjeje shumë të rëndësishme. Në gjysmëfinalen e parë do të takohen Penza-Bashkimi, kurse në atë të dytën Prishtina-Flamurtari.

Giresse publikon listën për miqësoret e marsit



PRISHTINË, 18 MARS - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Alain Giresse, e ka publikuar listën e futbollistëve për dy ndeshjet miqësore të këtij muaji. Futbollistët “dardanë” do të përballen me Burkina Faso më 24 mars në stadiumin “Fadil Vokrri” dhe kundër Zvicrës më 29 mars në Cyrih. Këto ndeshje janë të parat me trajnerin francez në krye të Përfaqësueses së Kosovës, e cila është drejtuar nga Bernard Challandes dhe Albert Bunjaki. Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se trajneri Alain Giresse më 21 mars do të mbajë konferencë për medie, kurse stërvitja e parë do të zhvillohet një ditë më vonë. “Trajneri francez më 21 mars do të paraqitet në

konferencë për medie në orën 11:00 në hotel ‘Emerald’, kurse stërvitja e parë do të mbahet më 22 mars në stadiumin ‘Fadil Vokrri’ në orën 16:00”, thuhet në njoftimin e FFK-së.

LISTA E FUTBOLLISTËVE

Arjanet Muriq, Samir Ujkani, Visar Bekaj, Mërgim Vjovoda, Florent Hadergjonaj, Amir Rrahmani, Fidan Aliti, Betim Fazliji, Mirind Kryeziu, Ibrahim Dresheviq, Lirim Kastrati, Toni Domgjoni, Blendi Idrizi, Florjan Loshaj, Valon Berisha, Milot Rashica, Emir Sahiti, Zymer Bytyqi, Edon Zhegrova, Florent Muslija, Elbasan Rashani, Vedat Muriqi, Astrit Selmani.

Shorti i Ligës së Kampionëve: Chelsea - Real dhe City - Atletico Madrid

NYON, 18 MARS - Shorti i fazës çerekfinale të Ligës së Kampionëve është hedhur sot në Nyon. Ndeshja kryesore e kësaj faze do të jetë në mes të Chelseat dhe Real Madridit. Ndeshje tjetër interesante do të jetë edhe në mes të skuadrës tjetër nga Madridi, Atletico Madridit dhe kampiones në fuqi të Premierë Ligës, Manchester City. Fituesi i ndeshjes Chelsea - Real Madrid do të përballen me fituesin e ndeshjes Manchester City - Atletico Madrid. Në gjysmëfinalen tjetër takohen fituesi i ndeshjes Benfica - Liverpool me fituesin e

ndeshjes Villarreal - Bayern Munchen. Ndeshjet e para çerekfinale zhvillohen më 5/6 prill, kurse ndeshjet e kthimit një javë më vonë, më 12/13 prill. Ndërsa ndeshjet e para të gjysmëfinalës së Ligës së Kampionëve zhvillohen më 26/27 prill, kurse ndeshjet e dyta 3/4 maj. Finalja e madhe zhvillohet më 28 maj në “Stade de France” të Parisit.

Shorti i Ligës së Evropës: Frankfurt - Barcelona

Në Nyon të Zvicrës është

NË ÇEREKFINALE TAKOHEN:

**Chelsea - Real Madrid
Manchester City - Atletico Madrid
Villarreal - Bayern Munchen
Benfica - Liverpool**

Shorti i çerekfinalës:

**Leipzig - Atalanta
Eintracht Frankfurt - Barcelona
West Ham - Lyon
Braga - Rangers**

hedhur edhe shorti për fazën çerekfinale të UEFA Ligës së Evropës. Tetë skuadrat më të



mira të këtij edicioni mësuan kundërshtarët e tyre në fazën çerekfinale. Ndeshjet e para

çerekfinale luhen më 7 prill, kurse ndeshjet kthyes luhen një javë më pas më 14 prill.

Telashe për Golden Staten, Curry do të mungojë gjatë

SAN FRANCISCO, 18 MARS - Basketbollisti i Golden State Warriorsit, Stephen Curry, i lënduar një ditë më parë në ndeshjen ndaj Bostonit, do të qëndrojë jashtë fushave për një kohë të papërcaktuar. Staf

mjekësor ka konfirmuar se ylli i NBA-së ka pësuar një ndrydhje të ligamenteve të këmbës së majtë. Skuadra e Golden States shpreson ta ketë në dispozicion lojtarin para datës 16 prill, kur nis faza

“play-off”. Gjithsesi, diçka më e saktë do të mësohet pas ekzaminimeve të tjera mjekësore që Curry do t'i kryejë në orët e ardhshme. Curry, 34 vjeç, u dëmtua gjatë një kontakti me Marcus Smart,

doli nga fusha duke ecur me ngadalë dhe nuk luajti më. Një mungesë e rëndësishme për skuadrën e Golden States, që humbet lojtarin e saj më të mirë.



Nesër zhvillohet ‘El Clasico’ e Kosovës në basketboll

PRISHTINË, 18 MARS - Në fundjavë zhvillohet xhiroja e 23-të në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll, duke dhuruar disa ndeshje mjaft interesante. Sfidat kryesore zhvillohet të dielën në mes të Pejës dhe Sigal Prishtinës, dy rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës. Takimet mes këtyre dy skuadrave kanë qenë gjithmonë interesante dhe kështu pritet edhe në këtë përballje. Pejanët kanë 14 fitore e shtatë humbje, ndërsa prishtinasit 11 fitore dhe 11 humbje. Në elitë këto dy skuadra janë ndeshur tri herë, ku dy fitore shënuan pejanët dhe një herë prishtinasit. Ndërkohë, “verdhezinjtë” i kanë eliminuar edhe për Kupë. Takimi i parë i kësaj xhiro zhvillohet ndërmjet Dritës dhe Rahovecit. Gjilanasit nuk kanë asnjë fitore në 22 ndeshje, duke qenë skuadra e vetme pa fitore në elitë, ndërkohë që “vreshtarët” kanë tetë fitore e 13 humbje, duke qenë në formë shumë të mirë në takimet e fundit. Të shtunën do të përballen Bashkimi me Golden



Eagle Yllin. Për prizrenasit është një sfidë shumë e rëndësishme, duke marrë parasysh se ndodhen në vendin e gjashtë me nëntë fitore e 13 humbje, për ta synuar “play-off”-in, ndërkohë që therandasit janë liderë me 16 fitore e pesë humbje. Të dielën, po ashtu, zhvillohet edhe një sfidë interesante mes Prizrenit 16 dhe Trepçës. Prizrenasit kanë 13 fitore e tetë humbje, ndërsa mitrovicasit 15 fitore e shtatë humbje. Të dyja

skuadrat synojnë titullin dhe do të luajnë vetëm për fitore në këtë pjesë të rëndësishme të kampionatit.

SUPERLIGA - Java 23

Të shtunën takohen:
17:00 Drita - Rahoveci
19:00 Bashkimi - Golden Eagle Ylli

Të dielën takohen:
17:00 Prizreni 16 - Trepça
19:00 Peja - Sigal Prishtina

Tre skitarë do ta përfaqësojnë Kosovën në EYOF Vuokatti 2022

PRISHTINË, 18 MARS - Komiteti Olimpik i Kosovës ka paraqitur ekipin olimpik që do të marrë pjesë në Festivalin Olimpik Evropian Dimëror për të Rinj (EYOF) Vuokatti 2022. EYOF Vuokatti 2022 mbahet prej 20 deri më 25 mars 2022 në Vuokatti të Finlandës. Ekipi olimpik përbëhet nga tre skitarët e skijimit alpin: Kiana Kryeziu, Arba Pupovci dhe Drin Kokaj, trajnerët Agim Pupovci e Bujar Turjaka, shefi i misionit Jeton Rudari dhe përgjegjësi për medie, Kushtrim Krasniqi. Në konferencën për shtyp, presidenti Ismet Krasniqi ka deklaruar se KOK-u ka bërë të gjitha përgatitjet derisa ekipin e ka dërguar edhe në përgatitje jashtë vendit. “Pritshmëritë tona janë që sportistët ta japin maksimumin dhe të kenë paraqitje sa më të mirë”, ka thënë Krasniqi. Kryetari i Federatës Skitare të Kosovës, Milaim Kelmendi, njëherësh nënpresident i KOK-ut, theksoi se pritshmëritë janë që të arrihen rezultate të mira edhe në



EYOF Trajneri Agim Pupovci foli për përgatitjet, derisa falënderoi KOK-un për mundësinë e dërgimit në përgatitje dyjavore në alpet e Austrisë, derisa theksoi se konkurrenca në EYOF është e madhe, pasi marrin pjesë sportistët më të mirë. Optimistë për përfaqësim sa më të mirë u shprehën edhe të tre skitarët të cilët thanë se është nder dhe kënaqësi që u është dhënë

mundësia ta përfaqësojnë Kosovën në këtë EYOF. Skitarët do të garojnë në disiplinat e slallomit dhe slallomit paralel. Ceremonia hapëse mbahet më 20 mars, kurse ekipi i Kosovës udhëton sonte në relacionin Prishtinë – Tiranë – Frankfurt dhe Vuokatti. Për Kosovën është pjesëmarrja e tretë në EYOF Dimëror, pas përfaqësimit në Erzurum 2017 dhe Sarajeva 2019.

SHKURT

Sahiti ftohet për herë të parë te Kosova

Emir Sahiti është ftuar për herë të parë nga Kombëtarja e Kosovës për dy ndeshjet miqësore që do të zhvillohen në muajin mars. “Dardanët” do të luajnë fillimisht me Burkina Fason në Prishtinë më 24 mars, teksa pesë ditë më pas do të përballen me Zvicrën në Cyrih. Trajneri i ri i Kosovës, Alain Giresse, ka filluar t'i dërgojë ftesat për ndeshjet e tij të para. Emri më i ri që pritet të jetë është mesfushori Emir Sahiti. Kjo është konfirmuar nga klubi kroat në të cilin luan, Hajduk Split. Sahiti këtë sezon ka zhvilluar 24 ndeshje, duke kontribuar me katër gola dhe dy asistime.

Verstappen: Do të shpalleme kampion bote edhe këtë vit

Nga Bahreini, ku këtë fundjavë zhvillohet gara e parë sezonale në Formula 1, piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, ka lëshuar sfidën. Kampioni i botës në fuqi u shpreh se edhe këtë vit do të shpallet kampion, duke mbrojtur titullin fituar mes aq shumë polemikave në garën e fundit. “Mirëpres mes pretendentëve këtë vit Ferrarin dhe kjo do të bëjë më të bukur garën. Kanë qenë të fortë në prova dhe do të jenë kompetitivë bashkë me ne dhe Mercedes”, ka thënë Verstappen. “Kush e fiton garën e parë sezonale? Unë. Kush do ta fitojë titullin? Sërisht unë. Rregulli i parë është besimi te vetja dhe unë asnjëherë nuk heq dorë. Jemi përmirësuar, por nuk e di se deri ku. Të dielën do ta kuptojmë realisht gjendjen e skuadrave”, u shpreh Verstappen.

Tuchel: Përballja ndaj Realit, emocionuese dhe e vështirë

Chelsea do të përballlet me Realin e Madridit në sfidat çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Pas shortit ka reaguar trajneri gjerman i Chelseat, Tomas Tuchel, i cili u shpreh: “Është ndeshje e vështirë. Nuk mund të ketë asgjë më të vështirë se të përballësh në kthim në ‘Bernabeu’ me fansat e tyre, por është edhe një simulim i madh. Do të jetë një sfidë emocionuese dhe e vështirë”. Ai foli edhe për disavantazhin e Chelseat, që nuk do të ketë tifozë në sfidën e parë. “Këto ndeshje janë bërë për fansat. Shpresoj të gjejmë një zgjidhje deri në atë datë. Nuk e di sa do të jenë mundësitë, por e di që këto ndeshje janë bërë për tifozët”, ka shtuar Tuchel.

Zbulohet oferta për kontratën e re të Lewandowskit

Robert Lewandowski dhe Bayern Muncheni ende nuk i kanë nisur bisedimet për ta rinovuar kontratën. Sulmuesit polak aktualja i përfundon më 30 qershor 2023. Së fundmi ka pasur shumë zhurmë dhe në Gjermani zbulojnë edhe si “bavarezët” do tentojnë ta “joshin” me një pagë më të lartë. Fatura në fund pritet të shkojë rreth 85 milionë euro. Kontrata do të jetë trivjeçare, deri më 30 qershor 2025, ndërsa paga do t'i bëhet nga 20 milionë euro në 28 milionë euro.

Alves: Messi nuk është i lumtur në Paris

Dani Alves nuk është i bindur se Lionel Messi po kënaqet në Paris Saint-Germainin. Messi, i cili nënkroi një marrëveshje dyvjeçare me skuadrën e Ligës 1 dhe fiton 35

milione funte në sezon, nuk ka treguar formën që kishte me Barcelonën sezonin e kaluar. Dani Alves mendon se 34-vjeçari duhet të kthehet në Barcelonë për ta parë karrierën e tij.

“Për mua, jo, ai nuk po kënaqet (në Paris Saint-Germain). Sepse Leo e bën këtë lojë të veçantë dhe këtë e bën kur po kalon mirë, sepse kur ai kalon mirë, të tjerët e shijojnë. Për mua nuk

është në vend, tani Leo nuk është në vendin e duhur atje. Sepse Leo për mua ka jetuar në vendin më të mirë në botë për ta praktikuar atë që do”, ka thënë Alves.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Andersson Group” SH.P.K. me pronar Hanife Andersson Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810065369 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Andersson Group” D.O.O. Hanife Andersson Gjilan donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810065369 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Andersson Group” L.L.C. Hanife Andersson Gjilan has come to the decision to quit its business: 810065369 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek “**REB BULLI**”, në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:
044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**NJOFTIM**

TRAFIKU URBAN SH.A njofton se me date 18.03.2022 mbyllet njoftimi i shpallur në gazetën ditore “Epoka e Re” me datën 01.03.2022 “ Shprehje Interesi për ofrimin e shërbimeve të marketingut”

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Veli Shatri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Bajram Curi " Romaje.
- ▶ Emine Bobaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmoret e Kabashit " Korishe.
- ▶ Nezir Morina shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Clirim Kastrati shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Valton Cafleshi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Ajser Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl X shme " Ymer Prizreni " Prizren.
- ▶ Dimitrije Krstic shpall te pavlefshme 2 dëftesat shmlt " 11 Marsi " Prizren.
- Lirigzon Gubetini shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “28 Nëntori” Prishtinë.
- ▶ “Durguti-E” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810394792.
- ▶ Nakshije Maloku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1. 2. 3. 4 si dhe diplomën e shkollës së mesme të Bujqësisë “Arbëria” Gjilan.
- ▶ Nakshije Maloku shpall të pavlefshme dëftesat nga kl, 1 deri 8 të shkollës fillore “Selami Hallaqi” Gjilan.
- ▶ Shemsije Thaqi shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan.
- ▶ Shemsije Maloku shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme “Arbëria” Gjilan.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

- Quality & Sales Award Recipients**
(Listed in alphabetical order)
- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
 - ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
 - ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
 - ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
 - ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
 - ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
 - ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
 - ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
 - ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
 - ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

